

# PARLAMENTI I KROACISË

712

Në zbatim të nenit 88 të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, miratoj

## **VENDIMIN**

### **PËR SHPALLJEN E LIGJIT "PËR PRODHIMIN, RIPARIMIN DHE TREGTINË E ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE"**

Shpallja e ligjit "Për prodhimin, riparimin dhe tregtinë e armëve dhe pajisjeve ushtarake", të miratuar nga Parlamenti Kroat në mbledhjen e 19 marsit 2002.

Numër: 01-081-02-1299/2

Zagreb, më 25 Mars 2002.

Presidenti  
i Republikës së Kroacisë  
**Stipe Mesić**, v. r.

## **LIGJ**

### **PËR PRODHIMIN, RIPARIMIN DHE TREGTINË E ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE**

Kapitulli I.

#### DISPOZITA THEMELORE

Neni 1.

Ky ligj rregullon: planifikimin, zhvillimin e prodhimit dhe riparimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake; kriteret për përcaktimin dhe përdorimin e kapacitetit për prodhimin dhe riparimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake; tregtinë e armëve dhe pajisjeve ushtarake; sigurimin dhe mbrojtjen e prodhimit dhe tregtisë së armëve dhe pajisjeve ushtarake; verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e parashikuara për armët dhe pajisjet ushtarake; prodhimin dhe riparimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake gjatë luftës dhe në rastin e kërcënimit të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe unitetit të Republikës së Kroacisë, si dhe dhënien e patentave për shpikjet që janë me interes për çështjet e mbrojtjes.

Neni 2.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, terma të caktuara të përdorura në të kanë kuptimet e mëposhtme:

1. "Armë dhe pajisje ushtarake" armët, pajisjet luftarake dhe pajisjet dhe sistemet e destinuar për pajisjen, përdorimin, administrimin, ruajtjen, magazinimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e pajisjeve të armëve, luftarake dhe teknike (në vijim referuar si: NVO).

2. "Prodhim i NVO-ve" është veprimtaria që përfshin projektimin e pajisjeve dhe sistemeve të reja të NVO-së, zhvillimin e prototipave, projektimin – konstruktimin, prodhimin e pakët dhe masiv të NVO-së, zhvillimin e teknologjive të reja në kohë paqeje dhe përgatitjen për prodhimin e NVO-se në kohë lufte dhe në rast kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë.

3. "Riparim i NVO-ve" janë punimet të cilat i kryhen në NVO për mirëmbajtjen dhe arritjen e rregullsisë teknike dhe funksionale të tyre.

4. "Shpenzime operative" është kompensimi monetar që Qeveria e Republikës së Kroacisë i paguan prodhuesit të NVO-ve për mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve për prodhimin e NVO-ve gjatë kohës që ato nuk janë funksionale, por që janë me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e Republikës së Kroacisë.

5. "Shërbime" janë të gjitha aktivitetet (profesionale, të ndërmjetësimit dhe të tjera) në lidhje me procesin e prodhimit, riparimit dhe tregtisë së NVO-së, të ofruara sipas ligjit "Për prokurimin publik".

6. "Kapacitete për prodhimin dhe riparimin e NVO-ve" janë objektet dhe potencialet prodhuese me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e Republikës së Kroacisë ndaj të cilave zbatohen rregulla të posaçme procedurale dhe disponueshmërie në kohë paqeje, lufte dhe në rast kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë.

7. "Objektet dhe potencialet prodhuese me rëndësi të veçantë për mbrojtjen" janë objektet e institucioneve të kërkimit shkencor të përfshira në zhvillimin e NVO-ve, objektet në të cilat kryhet prodhimi, mirëmbajtja, magazinimi dhe ruajtja e NVO-ve, infrastruktura mbështetëse, ambientet e prodhimit dhe pajisje të tjera të përfshira në procesin teknologjik të prodhimit të NVO-ve.

8. "Sigurimi dhe mbrojtja e prodhimit dhe tregtisë së NVO-ve" është sistemi gjithëpërfshirës i masave siguruese-mbrojtëse, normave dhe mjeteve, i cili parandalon asgjësimin ose dëmtimin e kapaciteteve, kërcënimin e sigurisë së njerëzve dhe të pronës ose tjetërsimin e prodhimit të NVO-ve dhe përcakton zbatimin e masave të posaçme mbrojtëse gjatë administrimit të lëndëve të rrezikshme

9. "Programi i kompensimit" është një program që përcakton detyrimet e furnizuesit të huaj NVO-sh ndaj një kontrate për furnizimin e NVO-ve për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes

10. "Rezerva të mjeteve materiale" janë makineritë, veglat, lëndët e para, montimet dhe gjysmë montimet e nevojshme për organizimin e prodhimit dhe riparimit të NVO-ve në luftë dhe në rastin e kërcënimit të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë.

### Neni 3.

Agjencia e Qeverisë Kroate (në vijim referuar si: Agjencia) mbikëqyr prodhimin për qëllime eksporti, importin dhe eksportin e NVO-ve dhe administron bazën unike të të dhënave për NVO-të e importuara dhe të eksportuara.

Përveç detyrave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Agjencia kryen, për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë (në vijim referuar si: Forcat e Armatosura) dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, shitjen e NVO-ve joperspektive.

Agjencia themelohet nga Qeveria e Republikës së Kroacisë, me akt nënligjor të posaçëm.

### Neni 4.

Qeveria e Republikës së Kroacisë, me anë të një akti nënligjor të posaçëm, përshkruan se çfarë nënkuptohet me armë dhe pajisje ushtarake për nevoja të Forcave të Armatosura dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## Kapitulli II.

### PLANIFIKIMI I PRODHIMIT DHE RIPARIMIT TË ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE.

### Neni 5.

Prodhimi i NVO-ve për nevoja të Forcave të Armatosura bazohet në planin afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura, i cili miratohet nga parlamenti kroat, me propozim të qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Prodhimi e NVO-ve për qëllime eksporti kryhet në bazë të kontratës me prodhuesin sipas nenit 6 paragrafi 1 të këtij ligji dhe blerësin, me miratim paraprak nga agjencia e përmendur në nenin 3 i këtij ligji.

Pavarësisht dispozitës së parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, për nevoja të eksportit të NVO-së, kontratë me prodhuesin mund të lidhë edhe agjencia.

#### Neni 6

NVO mund të prodhojnë:

– subjektet juridike (në vijim referuar si "prodhuesit"), të cilat janë regjistruar për prodhim për qëllime të veçanta dhe bëjnë pjesë në listën e prodhuesve të miratuar të NVO-ve, të miratuar nga qeveria e Republikës së Kroacisë me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes,

– Ndërmjetësuesit (në vijim referuar si "prodhues") që prodhojnë NVO dhe bëjnë pjesë në listën e prodhuesve të miratuar të NVO-ve, të miratuar nga qeveria e Republikës së Kroacisë me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes.

Prodhuesit prodhojnë NVO për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes, në bazë të kontratës që lidhin me këtë të fundit në përputhje me planin afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura; dhe për nevoja të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bazë të kontratave që lidhin me këtë ministri.

Qeveria e Republikës së Kroacisë përcakton, me anë të një akti nënligjor të posaçëm, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë prodhuesit.

#### Neni 7

Kompania ose emri i prodhuesit, ose i degës së prodhuesit nuk mund të mbajnë shenjën e aktivitetit që lidhet me prodhimin për qëllime të veçanta.

Prodhuesit duhet të vendosen në territorin e Republikës së Kroacisë.

#### Neni 8

Të drejtën për të zhvilluar NVO, për të zhvilluar prototipa ose pjesë të prototipave të NVO-ve dhe për të miratuar teknologjinë e prodhimit dhe të riparimit të NVO-ve e kanë prodhuesit, institucionet e kërkimore shkencore dhe objektet e riparimit të Forcave të Armatosura dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ministri i mbrojtjes, me pëlqim të ministrit të punëve të brendshme, përcakton kushtet e posaçme për kryerjen e operacioneve të zhvillimit të NVO-ve që duhet të plotësojnë prodhuesit dhe institucionet kërkimore shkencore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 9

Riparimi i NVO-ve mund të kryhet nga prodhuesit, personat juridikë të regjistruar për kryerjen e riparimit të NVO-ve mbi bazën e miratimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së punëve të brendshme, në kapacitetet e tyre të riparimit.

### Kapitulli III.

#### KRITERET PËR PËRCAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E KAPACITETEVE PËR PRODHIMIN DHE RIPARIMIN E ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE

#### Neni 10

Ndërtimi, rikonstruksioni ose modernizimi dhe përdorimi i kapaciteteve për prodhimin dhe riparimin e NVO-ve kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fushën e mbrojtjes, rregullimit të territorit, mbrojtjes së mjedisit dhe ndërtimit dhe në përputhje me ligjin "Për lëndët plasëse për përdorim tregtar".

#### Neni 11

Kapacitetet për prodhimin dhe riparimin e NVO-ve të prodhuesve sipas nenit 6 paragrafi 1 i këtij ligji mund të vendosen të qarkullim juridik (tjetërsim, ngarkim, zbatim etj.) dhe ndaj subjektit juridik mund të nisë falimentimi vetëm me miratimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

#### Neni 12

Gjatë kohës që kapacitetet për prodhimin dhe riparimin e NVO-ve me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e Republikës së Kroacisë nuk janë në funksionim, prodhuesit që janë regjistruar për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit dhe riparimit të NVO-ve mund të ushtrjnë të drejtën e kompensimit monetar për shpenzimet operative. Prodhuesit i paraqesin Ministrisë së Mbrojtjes

kërkesën e specifikuar për kompensim monetar, për vitin buxhetor vijues, jo më vonë se 1 shtatori i vitit aktual.

Prodhuesit të cilët janë regjistruar për prodhimin e NVO-ve mund të kërkojnë kompensim monetar për shpenzimet e prodhimit në rast se u hiqet autorizimi për eksportin e artikujve NVO për qëllime tregtare, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Mjetet financiare për shpenzimet operative sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të ofrohen vetëm për kapacitetet e prodhimit dhe riparimit të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për mbrojtjen e Republikës së Kroacisë.

Qeveria e Republikës së Kroacisë përcakton, me anë të një akti nënligjor të posaçëm, kriteret bazë që duhet të përmbushin prodhuesit për të ushtruar të drejtën për kompensimi monetar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

Në bazë të kërkesës sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Ekonomisë, përcakton arsyeshmërinë e çdo kërkesë të veçantë dhe kërkesat e arsyeshme ia dërgon Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Qeveria e Republikës së Kroacisë, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, përcakton shumën dhe numrin e kompensimeve monetare në përputhje me fondet e siguruar në buxhetin shtetëror të Republikës së Kroacisë.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për institucionet e kërkimit shkencor me rëndësi për zhvillimin e NVO-ve.

#### Neni 13

Të dhënat rreth objekteve dhe potencialeve prodhuese me rëndësi të veçantë për mbrojtjen i administron Ministria e Mbrojtjes.

Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni përbën sekret ushtarak dhe ruhet në përputhje me aktet nënligjore që rregullojnë të informacionin konfidencial të mbrojtjes dhe procedurat e veçanta e të përgjithshme për ruajtjen e tij.

#### Neni 14

Subjekteve juridike të huaja me seli jashtë Republikës së Kroacisë mund t'u miratohet investimi i kapitalit dhe realizimi i interesave ekonomike në fushën e prodhimit të NVO-ve.

Investimi i kapitalit kryhet sipas programit të investimit të miratuar nga Ministria e Ekonomisë me propozim nga Ministria e Mbrojtjes ose Ministria e Punëve të Brendshme.

Të dhënat rreth investitorëve të huaj administrohen nga Ministria e Ekonomisë.

### Kapitulli IV.

#### TREGTIA E ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE.

#### Neni 15.

"Tregti e NVO-ve" janë operacionet tregtare dhe ofrimi i shërbimeve në lidhje me NVO-në.

Operacionet tregtare kanë të bëjnë me prokurimin, shitjen dhe prokurimin për shitje.

Operacionet e ofrimit të shërbimeve kanë të bëjnë me transportin, magazinimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e NVO-ve.

#### Neni 16

Tregti e NVO-ve brenda vendit mund të kryhet nga prodhuesit, në përputhje me rregulloret për tregtinë.

Prodhuesit e pajisjeve minuese-shpërthyesë i tregtojnë ato në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në përputhje me normat dhe konventat ndërkombëtare.

Prodhuesit kanë detyrimin që të mbajnë të dhëna për NVO-të e vendosura në treg dhe, sa herë që vendosin në treg NVO, t'i dërgojnë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme një kopje të evidencës.

#### Neni 17

Operacionet e importit dhe eksportit të NVO-ve për nevoja të Forcave të Armatosura dhe të

Ministrisë së Punëve të Brendshme kryhen nga Agjencia.

Operacionet e importit dhe eksportit të NVO-ve për qëllime tregtare, përveç Agjencisë kryhen edhe nga subjektet juridike të autorizuara për importin dhe eksportin e NVO-ve.

Autorizimi për importin e NVO-ve për nevojat e Forcave të Armatosura dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lëshohet nga Ministria e Mbrojtjes ose Ministria e Punëve të Brendshme.

Autorizimi për importin e NVO-ve për qëllime tregtare lëshohet nga Ministria e Ekonomisë, me miratim paraprak të Komisionit, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Ekonomisë.

Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë, për qëllime të mbajtjes së një baze të vetme të dhënash, njoftojnë Agjencinë me shkrim në lidhje me autorizimet e lëshuara për import dhe eksport të NOV-ve.

#### Neni 18

NVO-të klasifikohen në formën e importit dhe eksportit në regjimin e autorizimit në përputhje me ligjin "Për tregtinë".

Klasifikimi i NVO-ve në formën e importeve dhe eksporteve kryhet nga qeveria e Republikës së Kroacisë, me propozim nga Ministria e Mbrojtjes dhe me miratim nga Dhoma Tregtare e Kroacisë.

#### Neni 19

NOV mund të vendoset në treg vetëm nëse vendoset se është në përputhje me kërkesat për NVO-të sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare.

#### Neni 20

Transporti i NVO-ve përmes territorit të Republikës së Kroacisë mund kryhet nëpërmjet pikave të kalimit kufitar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshjet.

Miratimi për transport të NVO-ve përmes territorit të Republikës së Kroacisë jepet nga Ministria e Punëve të Brendshme, me miratimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Për transportin e NVO-ve, zbatohen sipas rastit aktet nënligjore për transportin e armëve.

#### Neni 21

Kontrata për prokurimin e NVO-ve për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme përgjithësisht lidhet me prodhues vendas.

Qeveria e Republikës së Kroacisë rregullon, me anë të një ligji të veçantë, kushtet, kriteret, mënyrën dhe procedurën sipas së cilës do të lidhet kontrata me prodhuesin vendas.

Kontrata për prokurimin e NVO-ve me transportues të huaj, në varësi të vlerës së NVO-ve që prokuroren, mund të lidhen si "program kompensimi".

Ministri i mbrojtjes dhe ministri i ekonomisë përcaktojnë procedurën për mënyrën dhe kushtet e zbatimit të "programit të kompensimit" në kontratën për prokurimin e NVO-ve që lidh me furnitorë të huaj.

### Kapitulli V.

## SIGURIMI DHE MBROJTJA E PRODHIMIT DHE TREGTISË SË ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE

#### Neni 22

Sigurimi, mbrojtja dhe zhvillimi i prodhimit, tregtisë dhe riparimit të NVO-ve kryhet në përputhje me këtë ligj, ligjin "Për mbrojtjen", ligjin "Për ruajtjen e informacionit konfidencial", ligjin "Për lëndët plasëse për përdorim tregtar" dhe rregulloret e tjera që rregullojnë sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen gjatë administrimit të lëndëve të rrezikshme.

#### Neni 23

Masat e sigurisë dhe mbrojtjes sipas nenit 22 të këtij duhet të zbatohen nga prodhuesit, institucionet e kërkimit shkencor, Forcat e Armatosura dhe Ministria e Punëve të Brendshme, në kapacitetet e tyre të riparimi, si dhe nga bashkëaksionarët e tjerë të përfshirë në tregtimin e NVO-ve.

Masat e përgjithshme dhe të veçanta që përbëjnë sistemin tërësor të sigurisë dhe mbrojtjes sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohen nga ministri i mbrojtjes.

Zbatimi i masave të sigurisë dhe mbrojtjes nga ana e subjekteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, mbikëqyret nga shërbimet kompetente të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### Neni 24

Me të dhëna sekrete të mbrojtjes në zonën e prodhimit dhe të tregtisë së NVO-ve nënkuptohen:

1. Të dhënat për planet e prodhimit të NVO-ve dhe të realizimit të tyre,
2. Të dhënat për programet e kërkimit dhe zhvillimit të NVO-ve,
3. Të dhënat për kapacitetet për prodhimin e NVO-ve,
4. Të dhënat për procedurën teknologjike të prodhimit të NVO-ve dhe të dokumentacionit të konstruksionit,
5. Të dhënat për importin dhe eksportin e NVO-ve,
6. Të dhënat për bashkëpunimin tekniko-shkencor me partnerët jashtë vendit,
7. Të dhënat për krijimin, rigjenerimin, shfrytëzimin dhe shpërndarjen hapësinore të rezervave të materialeve të luftës për qëllime prodhimi dhe riparimi.

#### Neni 25

Prodhuesit kanë detyrimin që të organizojnë mbrojtjen e kapaciteteve nga hyrja e personave të paautorizuar, për mbrojtjen përkatëse fiziko-teknike sipas ligjit "Për mbrojtjen e njerëzve dhe të pronës".

### Kapitulli VI.

#### PËRCAKTIMI I PËRPUTHSHMËRISË ME KËRKESAT E PARASHIKUARA PËR ARMËT DHE PAJISJET USHTARAKE

#### Neni 26

Përputhshmëria me kërkesat e përshkruara për NVO-të, gjatë procesit të prodhimit dhe riparimit, dhe përpara vendosjes së NVO-ve në treg, përcaktohet nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga personat juridikë të autorizuar (të akredituar) nga Byroja Kombëtare e Standardeve dhe Metrologjisë.

Gjatë procesit të prodhimit dhe riparimit, për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat për NVO-të, ministri i mbrojtjes është i autorizuar që t'u dërgojë prodhuesve edhe persona që nuk janë në shërbim në Ministrinë e mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura.

Prodhuesve të NVO-ve u kërkohet që t'u sigurojnë personave sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, kushtet për konfirmimin e përputhshmërisë me kërkesat e parashikuara për NVO-të.

#### Neni 27

Konfirmimi i përputhshmërisë me kërkesat e parashikuara për NVO-të kryhet në bazë të rregullores për cilësinë e produktit, e cila përcakton:

1. Të dhënat teknike për mjetet ose sistemet e NVO-ve,
2. Përmbajtjen e mjeteve ose sistemeve të NVO-ve,
3. Dokumentacionin teknik përkatës,
4. Kërkesat e cilësisë së mjeteve ose sistemeve të NVO-ve,
5. Metodat e testimit dhe të verifikimit të treguesve të parashikuar të cilësisë,
6. Kriteret për përcaktimin dhe vlerësimin e cilësisë së mjeteve dhe sistemeve të NVO-ve.

Rregullorja për konfirmimin e përputhshmërisë dhe cilësisë së produkteve për NVO miratohet nga ministri i mbrojtjes. Rregullorja për konfirmimin e përputhshmërisë dhe cilësisë së produkteve për NVO-të për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme miratohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

### Kapitulli VII.

PRODHIMI DHE RIPARIMI I ARMËVE DHE PAJISJEVE USHTARAKE GJATË LUFTËS DHE  
NË RAST KËRCËNIMI TË DREJTPËRDREJTË TË PAVARËSISË DHE INTEGRITETIT TË  
REPUBLIKËS SË KROACISË

Neni 28

Krahas prodhuesit, me prodhim dhe riparim të NVO-ve gjatë luftës dhe në rast kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë, mund të merren edhe persona të tjerë juridikë të caktuar nga Ministria e Mbrojtjes me propozim të Ministrisë së Ekonomisë.

Personat juridikë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund ta ndryshojnë aktivitetin vetëm me miratim nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 29

Për qëllime të prodhimit dhe riparimit të NVO-ve gjatë luftës dhe në rast kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë, sigurohen rezervat e nevojshme të burimeve materiale, në përputhje me ligjin.

Fondet për financimin e rezervave të burimeve materiale për prodhimin dhe riparimin e NVO-ve gjatë luftës dhe në rast kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë, sigurohen nga buxheti shtetëror i Republikës së Kroacisë.

Neni 30

Qeveria e Republikës së Kroacisë është e autorizuar që, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, të miratojë aktet nënligjore me të cilat rregullohet krijimi, përtëritja, shfrytëzimi dhe shpërndarja territoriale e rezervave të burimeve materiale për nevojat e prodhimit dhe riparimit sipas nenit 29 të këtij ligji.

Mbikëqyrja e administrimit të rezervave të burimeve materiale për prodhimin dhe riparimin sipas nenit 29 të këtij ligji i kryhet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Ekonomisë.

Neni 31

Në rast se, për shkak të kushteve të luftës ose kushteve të lindura nga kërcënimi i drejtpërdrejtë i pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë, prodhuesit nuk mund të disponojnë burimet për prodhimin, lëndët e para dhe lëndët riprodhuese ose mjetet e tjera të punës, Ministria e Mbrojtjes me miratimin e Ministrisë së Ekonomisë, në përputhje me planin e zhvillimit dhe administrimit të forcave të armatosura, mund të marrë vendimin që këto fonde t'i vihen në dispozicion dhe t'i transferohen një personi tjetër juridik që prodhon NVO sipas dispozitave të këtij ligji.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohet edhe për persona të tjerë juridikë mjetet e prodhimit, lëndët e para, lëndët riprodhuese dhe mjetet e tjera të punës të cilëve mund të përdoren për prodhimin e NVO-ve.

Neni 32

Tregtia e NVO-ve në kushte lufte dhe në rast kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë, përveçse nga prodhuesit dhe agjencia, kryhet edhe nga Ministria e Mbrojtjes.

Kapitulli VIII.

PATENTAT

Neni 33

Aplikimi për patenta për shpikje me interes për çështjet e mbrojtjes dorëzohet pranë Institutit Shtetëror për Pronësinë Intelektuale (në vijim referuar si: Instituti), në përputhje me aktet nënligjore për patentat.

Nëse aplikanti cilëson në aplikim ose nëse gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikimit për patentë përcaktohet se bëhet fjalë për një shpikje me rëndësi për çështjet e mbrojtjes, ky fakt i njoftohet menjëherë me shkrim, në çdo rast përpara publikimit të aplikimit për patentë në "Fletoren zyrtare", Ministrisë së Mbrojtjes, të cilës i përcillet kopja e përmbajtjes së aplikimit për patentë të dorëzuar.

Shpikjet sipas paragrafit 2 të këtij neni konsiderohen konfidenciale derisa të konfirmohet se nuk janë me rëndësi për mbrojtjen. Aplikimet për patentë për këto shpikje nuk publikohen në fletoren zyrtare dhe instituti siguron trajtimin konfidencial të tyre në përputhje me rregulloret e tij të brendshme.

Ministria e Mbrojtjes, jo më vonë se 90 ditë nga marrja e njoftimit nga Instituti, njofton këtë te fundit me shkrim nëse shpikja konfidenciale në fjalë është me interes për çështjet e mbrojtjes.

Nëse Ministria e Mbrojtjes i dërgon Institutit një njoftim ku cilësohet se bëhet fjalë për shpikje konfidenciale, Instituti ia transferon çështjen Ministrisë së Mbrojtjes.

Nëse në afatin sipas paragrafit 4 të këtij neni, Ministria e Mbrojtjes nuk njofton Institutin mbi ekzistencën e interesit për objektin e aplikimit për patentë, shpikja do të konsiderohet se nuk është me interes për çështjet e mbrojtjes.

#### Neni 34

Ministria e Mbrojtjes kryen procedurat administrative për dhënien e patentës për shpikje konfidenciale.

Vendimet e marra sipas procedurës administrative të përmendur në paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të apelojnë.

Në qoftë se Ministria e Mbrojtjes në procedurën e testimi të kushteve për njohjen e patentave për kalim të raportimit të patentës si shpikje konfidenciale, konfirmon që shpikja nuk është me interes për çështjet e mbrojtjes, ajo njofton për këtë aplikantin për patentë dhe Institutin dhe ky i fundit e kalon çështjen për përpunim të mëtejshëm.

#### Neni 35

Nëse Ministria e Mbrojtjes, pas njohjes së patentës si shpikje konfidenciale, vendos se shpikja nuk është më me interes për çështjet e mbrojtjes, ajo njofton për këtë mbajtësin e patentës dhe Institutin, të cilin do t'i dërgojë të gjithë objektin që lidhet me këtë patentë.

Me kërkesë me shkrim nga mbajtësi i patentës brenda 90 ditësh nga marrja e njoftimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, Instituti do të nisë procedurën përkatëse për dhënien e patentës në përputhje me aktet nënligjore për patentat, duke marrë parasysh edhe rezultatet e procedurës së kryer nga Ministria e Mbrojtjes.

Nëse përmbushen të gjitha kushtet e parashikuara në ligjin "Për patentat", Instituti e regjistron patentën në regjistrin e patentave.

#### Neni 36

Ministria e Mbrojtjes ka të drejtën ekskluzive të shfrytëzojë shpikjen konfidenciale dhe ta mbajë atë në dispozicion.

Për shpikje konfidenciale të mbrojtur me patentë, shpikësi ka të drejtën e kompensimit të njëhershëm pavarësisht nëse do të shfrytëzohet shpikja për nevoja të çështjeve të mbrojtjes dhe në ç' masë do të shfrytëzohet.

Shuma sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me marrëveshje midis aplikantit dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje, aplikanti mund t'i kërkojë gjykatës kompetente që të përcaktojë shumën e kompensimit.

#### Neni 37

Shpikja konfidenciale nuk publikohet.

Mbrojtje për shpikje konfidenciale jashtë shtetit, të realizuar nga personat juridikë dhe fizik vendas, mund ta kërkojë vetëm me miratim të Ministrisë së Mbrojtjes.

#### Neni 38

Qeveria e Republikës së Kroacisë përcakton kriteret për përcaktimin e shpikjeve që konsiderohen konfidenciale dhe mënyrën e mbrojtjes së patentave për këto shpikje, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes.

### Kapitulli IX.



## DISPOZITAT PENALE

### Neni 39

Me gjobë nga 20 000,00 deri në 100 000,00 kuna dënohet personi juridik i cili, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji:

1. Paraqet në emër treguesin e aktivitetit për qëllime të veçanta (neni 7 paragrafi 1),
2. Në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ndërton objekte për prodhimin, mirëmbajtjen, magazinimin dhe ruajtjen e NVO-ve (neni 10),
3. Vendos në qarkullim juridik kapacitete për prodhimin dhe riparimin e NVO-ve, pa miratimin e Ministrisë së Mbrojtjes (neni 11),
4. Importon ose eksporton NVO në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 17),
5. Nuk merr masat e sigurisë dhe të mbrojtjes për prodhimin, tregtimin dhe riparimin e NVO-ve (neni 23 paragrafi 2),
6. Vendos në dispozicion të personave të paautorizuar informacion të klasifikuar në lidhje me mbrojtjen, prodhimin dhe tregtimin e NVO-ve (neni 24),
7. Ndryshon aktivitetin pa miratim nga Ministria e Mbrojtjes (neni 28 paragrafi 2),
8. Publikon shpikjen konfidenciale në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 37 paragrafi 1),

Në rast shkeljeje të përsëritur sipas paragrafit 1 të këtij neni, personit juridik, përveç gjobës, mund t'i komunikohet edhe masa mbrojtëse e ndalimit të përkohshëm të aktivitetit të prodhimit të NVO-ve për një periudhë deri në një vit.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet edhe personi përgjegjës i subjektit juridik, me një gjobë nga 5000,00 deri në 50 000,00 kuna

## DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRMBYLLËSE

### Neni 40

Qeveria e Republikës së Kroacisë, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton aktet nënligjore për:

- kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë prodhuesit e NVO-ve (neni 6 paragrafi 3),
- themelimin e Agjencisë së Qeverisë së Republikës së Kroacisë për kryerjen e operacioneve të mbikëqyrjes së prodhimit të NVO-ve për qëllime eksporti dhe importi (neni 3 paragrafi 2),
- kriteret për përcaktimin e shpikjeve si konfidenciale dhe mënyrën e njohjes së patentave dhe të këtyre shpikjeve (neni 38).

### Neni 41

Ministri i mbrojtjes dhe ministri i ekonomisë kanë kompetencat për të miratuar, brenda 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, udhëzues për zbatimin e "programit të kompensimit" në kuadrin e lidhjes së kontratave për NVO me furnitorë të huaj.

Ministri i mbrojtjes ka kompetencat për të miratuar, brenda 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, rregullore për:

- Kushtet e posaçme për kryerjen e operacioneve të zhvillimit të NVO-së (neni 8 paragrafi 2),
- Masat e përgjithshme dhe të posaçme të sigurisë dhe mbrojtjes së prodhimit, tregtimit dhe riparimit të NVO-ve (neni 23 paragrafi 2),
- Përcaktimin e përputhshmërisë dhe cilësisë së produkteve të NVO-ve (neni 27 paragrafi 2).

### Neni 42

Dispozitat e këtij ligji që zbatohen për prodhuesit e NVO-ve zbatohen nën të njëjtat kushte edhe për subjektet juridike që merren me riparimin e NVO-ve.

### Neni 43

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon së zbatuari: Ligji "Për prodhimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake ("Fletorja zyrtare", nr. 52/91), ligji "Për prodhimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake dhe për marrëdhëniet ekonomike dhe marrëdhëniet e tjera në prodhimin dhe tregtinë e

armëve dhe pajisjeve ushtarake në rast gjendje lufte ose kërcënimi të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Kroacisë ("Fletorja zyrtare", nr. 55/91.), ligji "Për detyrimin e testimin të armëve, municionit dhe pajisjeve ("Fletorja zyrtare", nr. 56/92) dhe vendimi "Për produktet të cilat janë pjesë të armëve dhe pajisjeve për ushtrinë kroate, policinë, zyrën qendrore sanitare të Republikës së Kroacisë dhe organet për zbatimin e sanksioneve penale ("Fletorja zyrtare" nr. 6/93.) dhe dispozitat e nenit 104. - 110. Ligji "Për pronësinë industriale ("Fletoret zyrtare nr. 53/91., 19/92. dhe 26/93.).

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

Klasa: 213-02/02-01/02

Zagreb, 19 mars 2002.

PARLAMENTI I KROACISË

Kryetari

i parlamentit

**Zlatko Tomčić**, d.v.